

# STATISTIKA MBI NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

## Metadata Referenciale

|   |    |
|---|----|
| 1. Kontakt .....                            | 2  |
| 2. Përditësimi i metadatave .....           | 2  |
| 3. Paraqitja statistikore .....             | 2  |
| 4. Njësia matëse .....                      | 5  |
| 5. Periudha e referencës .....              | 5  |
| 6. Mandati institucional.....               | 5  |
| 7. Konfidencialiteti .....                  | 6  |
| 8. Politika e botimit.....                  | 7  |
| 9. Shpeshësia e shpërndarjes .....          | 7  |
| 10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia ..... | 7  |
| 11. Manaxhimi i cilësisë .....              | 8  |
| 12. Rëndësia .....                          | 9  |
| 13. Saktësia dhe besueshmëria .....         | 10 |
| 14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....     | 11 |
| 15. Koherenca dhe Krahasueshmëria .....     | 11 |
| 16. Kostoja dhe ngarkesa .....              | 12 |
| 17. Rishikimi i të dhënave.....             | 12 |
| 18. Përpunimi statistikor .....             | 13 |
| 19. Komente .....                           | 15 |
| Aneks .....                                 | 15 |

| <b>1. Kontakt</b>                      |   |
|--|---|
| 1.1. Institucioni i kontaktit          | Instituti i Statistikave, INSTAT  |
| 1.2. Njësia e kontaktit                | Sektori i Statistikave Strukturore, Drejtoria e Statistikave Ekonomike  |
| 1.3. Personi i kontaktit               | Ermira Muhaj (Palushi)  |
| 1.4. Funkzioni i personit të kontaktit | Përgjegjës, Sektori i Statistikave Strukturore  |
| 1.5. Adresa postare                    | Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë.   |
| 1.6. Adresa elektronike (e-mail)       | <a href="mailto:epalushi@instat.gov.al">epalushi@instat.gov.al</a>  |
| 1.7. Numri i telefonit                 | +(355) 4 233356 / 233/ 240  |
| 1.8. Numri i faksit                    | +(355) 4 2228300  |
| <b>2. Përditësimi i metadatave</b>     |   |
| 2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës  | 13.03.2024  |
| 2.2. Publikimi i fundit i metadatës    | 13.03.2024  |
| 2.3. Përditësimi i fundit i metadatës  | 13.03.2024  |
| <b>3. Paraqitja statistikore</b>       |   |
| 3.1. Përshkrimi i të dhënave           | <p>Të dhënat mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme paraqesin për përdoruesit, statistika mbi situatën e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve. Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve (ASN) ka për qëllim të ofrojë informacion mbi strukturën ekonomike, financiare dhe karakteristikat kryesore të ndërmarrjeve aktive në vend sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë së ndërmarrjes.</p> <p>Bazuar në ligjin Nr. 10042, datë 22.12.2008 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar, ndërmarrjet klasifikohen në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme.</p> <p>Për qëllime statistikore ndërmarrjet e vogla dhe të mesme do të trajtohen vetëm sipas numrit të të punësuarve (matur si të punësuar me kohë të plotë), të cilat klasifikohen si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mikrondërmarrje: ndërmarrjet me 1 deri 9 të punësuar;</li> <li>• Ndërmarrje të vogla: ndërmarrjet me 10 deri 49 të punësuar;</li> <li>• Ndërmarrje të mesme: ndërmarrjet me 50 deri 249 të punësuar.</li> </ul> |

|                                    |   |
|------------------------------------|---|
| <p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p> | <p>Klasifikimi i përdorur për statistikat strukturore të ndërmarrjeve është Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike (NVE). Të dhënat janë prodhuar në nivel vendi, të detajuara sipas aktivitetit ekonomik të grupuar në nivel dy shifror të kësaj nomenklature. Deri në vitin 2012, të dhënat janë mbledhur dhe publikuar duke përdorur NVE Rev.1.1. Duke filluar nga viti referencë 2013, të dhënat janë mbledhur dhe publikuar në NVE Rev.2. Për vitin referencë 2010-2012, është kryer kodifikimi i dyfishtë, në NVE Rev.1.1 dhe NVE Rev.2. Një gamë e gjerë e klasifikimeve statistike përdoret në statistikat e ndërmarrjeve. Lista e klasifikimeve të përdorura në prodhimin e statistikave strukturore të ndërmarrjeve është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev 2</a> NVE Rev.2;</li> <li>• <a href="#">Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev 1.1</a> NVE Rev.1.1;</li> <li>• <a href="#">Nomenklatura e Produkteve sipas Aktiviteteve</a> (NP 1996);</li> <li>• <a href="#">Nomenklatura e Produkteve sipas Aktiviteteve</a>, në versionin anglisht (NP 2008);</li> <li>• Rekomandimi i BE-së Nr. 2003/361 në lidhje me përkufizimet e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme;</li> <li>• Ligji Nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”;</li> <li>• Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat, NUTS 1 dhe NUTS 2 Ndërmarrjet janë të klasifikuara sipas madhësisë bazuar në numrin e të punësuarëve (punësuar me kohë të plotë).</li> </ul> |
| <p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>     | <p>Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve përfshijnë të gjitha ndërmarrjet aktive në Shqipëri, për të gjitha format ligjore. Popullsia është bazuar në ndërmarrjet të cilat, sipas Regjistrat Statistikor të Ndërmarrjeve, ishin aktive në dhjetor të vitit të referencës dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në një prej aktiviteteve të mbuluara nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve. Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve mbulojnë ndërmarrjet që operojnë në treg, të cilat bazuar në klasifikimin NVE Rev. 2, kanë aktivitet kryesor në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• (B) Industri nxjerrëse;</li> <li>• (C) Industri Përpunuese;</li> <li>• (D) Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar;</li> <li>• (E) Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit;</li> <li>• (F) Ndërtimi;</li> <li>• (G) Tregtia me shumicë dhe pakicë. Riparimi i automobilave e motorçikletave;</li> <li>• (H) Transport dhe Magazinim;</li> <li>• (I) Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit;</li> <li>• (J) Informacioni dhe Komunikacioni;</li> <li>• (L) Pasuritë e patundëshme;</li> <li>• (M) Aktivitetet Profesionale, Shkencore dhe teknike;</li> <li>• (N) Aktivitetet Administrative dhe Shërbimet mbështetëse;</li> <li>• (P) Arsimi;</li> <li>• (Q) Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale;</li> <li>• (R) Art, Argëtim dhe zbavitje;</li> <li>• (S) Aktivitete të tjera shërbimi (përfshijtur S94).</li> </ul>  |
| <p>3.4. Koncepte</p>               | <p><b>Treguesit bazë.</b></p>   |

|                                     |   |
|-------------------------------------|---|
| <p>statistikore dhe përkufizime</p> | <p><b>Ndërmarrja</b> është: "kombinimi më i vogël i njësive ligjore pra një njësi organizative që prodhon të mira apo shërbime që ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose me shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale)". Marrëdhënia mes një ndërmarrje dhe një njësie ligjore përkufizohet si: "ndërmarrja i korrespondon ose një njësie ligjore ose një kombinimi njësisish ligjore".</p> <p><b>Të punësuarit</b> përfshijnë të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjestarët e familjes të papaguar.</p> <p><b>Shitjet neto</b> përfshijnë shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë periudhës referuese dhe i korrespondojnë shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve ofruar të tretëve.</p> <p><b>Investimet</b> gjatë periudhës referuese përfaqësojnë vlerën e mallrave afatgjata të blera prej ndërmarrjeve ose të krijuara për llogari të vet me qëllim përdorimi për një periudhë jo më të vogël se një vit në procesin e prodhimit, përfshirë tokën.</p> <p><b>Tregues makroekonomikë.</b></p> <p><b>Prodhimi</b> është një aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale (ndërmarrje) që kombinon burimet e fuqisë punëtore, kapitalit dhe lëndës së parë, për të prodhuar të mira dhe kryer shërbime. Vlera e prodhimit bazohet në: Të ardhurat nga shitja e produkteve dhe shërbimeve (shitjet neto) të krijuara nga vetë ndërmarrja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• (±) Ndryshimet e gjendjen së produkteve të gatshme dhe në proces;</li> <li>• (±) Ndryshimet në gjendjen e mallrave dhe shërbimeve të blera për rishitje në të njëjtat kushte;</li> <li>• (-) Blerjet e mallrave dhe shërbimeve për rishitje në të njëjtat kushte;</li> <li>• (+) Prodhimi i aktiveve të qëndrueshme nga ndërmarrja për llogari të vet;</li> <li>• (+) Subvencionet.</li> </ul> <p><b>Konsumi ndërmjetës</b> përfaqëson vlerën e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk përfshihet në vlerën e konsumit ndërmjetës.</p> <p><b>Vlera e shtuar me çmime bazë</b> llogaritet si diferencë e vlerës së prodhimit me konsumin ndërmjetës.</p> <p><b>Eksportet</b> janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, të përpunimit pasiv, të rieksportuara për t'ju nënshtruar përpunimit aktiv.</p> <p><b>Importet</b> janë në përgjithësi mallra që vijnë nga një vend i tretë dhe të vendosura direkt në magazinat e ruajtjes, nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.</p> <p><b>Kategoria e mikrondërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM)</b> përfshin ato ndërmarrje, ku punësohen më pak se 250 persona.</p> <p><b>Ndërmarrje e vogël</b> quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 50 persona.</p> <p><b>Mikrondërmarrje</b> quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 10 persona.</p> |
| <p>3.5. Njësia statistikore</p>     | <p>Njësia statistikore e synuar dhe e vrojtuar është ndërmarrja. Të dhënat e publikuara sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë së ndërmarrjes i referohen ndërmarrjes.</p>  |

|  |   |
|--|---|
| 3.6. Popullata statistikore                | <p>Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet që prodhojnë të mira e shërbime në Shqipëri, për të gjitha format ligjore (nuk përfshihen aktivitetet e bujqësisë, peshkimit , aktivitetet e ndërmjetësimit monetar dhe financiar, administrata publike dhe e mbrojtjes si edhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare). Popullsia është bazuar në ndërmarrjet të cilat sipas regjistrit statistikor janë aktive në dhjetor të vitit referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2. Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Viti fiskal korrespondon me vitin kalendarik. Për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë mostër me zgjedhje për anketim. Ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.</p> <p>Baza e zgjedhjes janë të gjitha ndërmarrjet ku sipas Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve (RSN), janë aktive në dhjetorin e vitit referencë për aktivitet që mbulon Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njësitë lokale;</li> <li>• Ndërmarrjet që kanë kodin e aktivitetit ekonomik kryesor (NVE) jashtë qëllimit të këtij vrojtimi;</li> <li>• Ndërmarrjet shtetërore në aktivitetet e arsimit (NVE 85) dhe shëndetësisë (NVE 86, 87, 88).</li> </ul> |
| 3.7. Zona e referencës                     | Të dhënat e ASN (NVM) mbulojnë të gjithë territorin e vendit.   |
| 3.8. Mbulimi në kohë                       | Ky aktivitet statistikor ka filluar në vitin 1998, por vitet e para (deri në 2001) kanë shërbyer si periudhë tranzicioni. Të dhënat janë më të plota dhe të krahasueshme duke filluar nga viti referencë 2002. Deri në vitin referencë 2011, të dhënat janë publikuar në NVE Rev.1.1. Të dhënat e ASN janë rillogaritur me klasifikimin NVE Rev.2 nga viti referencë 2010 dhe në vazhdim.   |
| 3.9. Periudha bazë                         | Nuk aplikohet.  |
| 4. Njësia matëse                           | <p>Është përdorur numri si njësi matëse për listën e mëposhtme të treguesve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i ndërmarrjeve</li> <li>• Numri mesatar vjetor i të punësuarve</li> <li>• Vlera e Investimeve</li> <li>• Vlera e Prodhimit</li> <li>• Konsumi Ndërmjetës</li> <li>• Vlera e Shtuar</li> </ul>   |
| 5. Periudha e referencës                   | Të dhënat e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Ky raport i përket vitit referencë 2022.   |
| <b>6. Mandati institucional</b>            |   |
| 6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera | <p>Baza ligjore mbi të cilën mbështetet Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”;</a></li> <li>• <a href="#">Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026;</a></li> <li>• Vendimet e Këshillit të Statistikave. Duke qenë se, sipas ligjit të 6 statistikave zyrtare, roli i këtij organi është të mbikëqyrë, mbështesë dhe të marrë vendime në ndihmë të INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore për të</li> </ul>  |

|  |  |
|--|--|
|  | <p>siguruar hartimin dhe zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, aktet e miratuara nga ky organ janë të rëndësishme për ecurinë e zbatimit të aktiviteteve statistikore si dhe monitorimin e performancës së institucioneve përbërëse të sistemit kombëtar statistikor;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Memorandumet e bashkëpunimit të hartuara me institucionet e tjera edhe pse Shqipëria nuk është ende pjesë e Bashkimit Europian. INSTAT kryen të gjitha aktivitetet statistikore në përputhje me rregulloret respektive të Eurostat. Rezultatet e statistikave strukturore të ndërmarrjeve në mënyrë që të jenë të krahasueshme me ato të vendeve evropiane, prodhohen duke zbatuar edhe rregulloret e reja të Komisionit Evropian, KE: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Rregulloren (EC, EURATOM) No.58/97, 20 dhjetor 1996;</li> <li>○ Rregulloren e KE Nr.295/2008 mbi "Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve";</li> <li>○ Rregulloren e KE Nr. 1893/2006 mbi "Implementimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 në Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve;</li> <li>○ Rregulloren e KE Nr.250/2009 mbi "Definicionet e përdorura në Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve".</li> </ul> </li> </ul> |
| 6.2. Shkëmbimi i të dhënave                    | <p>Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve sipas madhësisë ende nuk kanë filluar të transmetohen në Eurostat. Aktualisht INSTAT plotëson një sërë pyetësorësh të organizmave ndërkombëtarë në lidhje me rezultatet e vrojtimit strukturor vjetor, si Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme e Ndërmarrjeve dhe Industrisë, OECD, etj.</p>  |
| <b>7. Konfidencialiteti</b>                    |  |
| 7.1. Konfidencialiteti - politika              | <p>Të dhënat e mbledhura konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018, "Për Statistikat zyrtare";, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrotjtja e të Dhënave Personale". Neni 31, i ligjit "Për Statistikat zyrtare" përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>   |
| 7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave | <p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregulloret, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</li> <li>b) Njësi statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të</li> </ul>  |

|   |   |
|---|---|
|   | <p>dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>   |
| <b>8. Politika e botimit</b>              |   |
| 8.1. Kalendari i publikimeve              | Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.   |
| 8.2. Akses në kalendarin e publikimeve    | <a href="#">Kalendari i Publikimeve</a> është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.   |
| 8.3. Akses i përdoruesve                  | <p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (NVM) janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Website – online release;</li> <li>• Kërkesat e shkruara (me postë ose <a href="#">email</a>);</li> <li>• Publikimi, Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, Statistika mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;</li> <li>• Seksioni, <a href="#">kërkesa të dhënash</a>, për përdoruesit e jashtëm.</li> </ul> |
| <b>9. Shpeshësia e shpërndarjes</b>       | Rezultatet mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) publikohen në baza vjetore.   |
| <b>10. Akses në të dhëna dhe qartësia</b> |   |
| 10.1. Njoftim për media                   | Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me katër treguesit kryesorë, numri i ndërmarrjeve, numri i të punësuarve, shitjet neto dhe investimet. Format i njoftimit për shtyp nuk ka ndryshuar; ajo është përcaktuar nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp publikohet online në faqen e internetit të INSTAT: <a href="#">Statistika mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme</a> .  |
| 10.2. Publikime                           | Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve gjenden të botuara në Vjetarin Statistikor. Përdoruesit mund ti gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT:   |



|                                   |   |
|-----------------------------------|---|
|                                   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Shifrat;</a></li> <li>• <a href="#">Vjetari Statistikor.</a></li> </ul>  |
| 10.3. Baza e të dhënave on-line   | Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e ASN nga viti 2002 si viti referencë. Bazën e të dhënave mund t'a aksesoni në linkun si vijon: <a href="#">Databaza Statistikore.</a>  |
| 10.4. Aksesimi në të dhënat mikro | Të dhënat e Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të Nenit 34 të Ligjit Nr. 17/2018.   |
| 10.5. Të tjera                    | Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për <a href="#">Kërkesë të Dhënash.</a>  |
| 10.6. Dokumentimi i metodologjisë | Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">metodologjinë.</a>   |
| 10.7. Dokumentimi i cilësisë      | Sektori i Statistikave Strukturore dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e Statistikave mbi Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) për qëllime të brendshme.   |
| <b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>   |   |
| 11.1. Sigurimi i cilësisë         | INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Nr.17/2018 “Për Statistikat zyrtare”, datë 05.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve. |
| 11.2. Vlerësimi i cilësisë        | Të dhënat mbi Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) nga ASN krahasohen me të dhënat në vitet e para për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha. Në rastet e ndryshimeve përdoren të dhënat administrative për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen diferenca të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.   |



## 12. Rëndësia

### 12.1. Nevojat e përdoruesit

Përdoruesit e Statistikave mbi Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm.

- Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë:
  - Institucione të administratës publike;
  - Universitetet;
  - Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare;
  - Bizneset;
  - Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme.

Botimi i rezultateve të ASN-së dërgohet çdo vit në një grup të caktuar përdoruesish. Disa tregues kryesorë dërgohen nga plotësimi i pyetësorëve të ndryshëm në Komisionin Europian, Drejtoria e Përgjithshme e Ndërmarrjeve dhe Industrisë, OECD, etj.

- Me përdorues të brendshëm nënkuptojmë:
  - Drejtoria e Llogarive Kombëtare;
  - Sektori i Statistikave Afat-Shkurtra;
  - Sektori i Regjistrimit statistikor të Ndërmarrjeve;
  - Sektori i Statistikave të Tregut të Punës;
  - Sektori i Gjeoinformacionit.

### 12.2. Kënaqësia e përdoruesit

INSTAT analizon çdo vit klikimet e faqes web dhe klikimet në lidhje me temën “Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve” për vitin 2023 janë 4.245.

INSTAT kryen çdo vit vrojtimin për matjen e [Kënaqësisë së Përdoruesve](#).

Rezultatet e vrojtimit për 2023 tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës “Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve ” është vlerësuar me 3.95 (79.08%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).

### 12.3. Plotshmëria

Plotshmëria e të dhënave të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të rregulloreve të ndjekura. Rezultatet e Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në mënyrë që të jenë të krahasueshme me ato të vendeve evropiane, prodhohen duke zbatuar edhe rregulloret e reja të Komisionit Evropian, KE:

- Rregulloren e Komisionit Evropian Nr.1893/2006 mbi “Implementimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike. NVE Rev.2 në Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve;
- Rregulloren e BE-së 2019/2152 mbi statistikave evropiane të biznesit (rregullorja EBS);
- Rregullen zbatuese 2020/1197 që përcakton specifikimet dhe marrëveshjet teknike (akti i përgjithshëm zbatues).Shkalla e Plotshmërisë të të dhënave, për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, bazuar në rregulloren [“Regulation\(EU\) 2019/2152 on European Business Statistics \(EBS Regulation\)”](#) dhe metodologjive të përdorura nga Eurostat është në përputhshmëri të mirë.

### 13. Saktësia dhe besueshmëria

#### 13.1. Saktësia e përgjithshme

Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime të dhënave të anketës kontrollohen me pasqyrat financiare ose me burime administrative nëse ka informacion. Kur nuk ka informacion nga burimet administrative INSTAT korrigjon ose konfirmon të dhënat duke përdorur email ose duke telefonuar personat që i janë përgjigjur anketës. Masat e marra nga INSTAT çdo vit, për të rritur normat e përgjigjes, ose për të zvogëluar ndikimin e mos përgjigjeve janë si më poshtë:

- Të dhënat merren drejtpërdrejt nga ndërmarrja;
- Informacioni është mbledhur me intervistim ballë për ballë nga anketuesit në bazë të udhëzimeve të përgatitura për këtë qëllim;
- Stafit anketues është i trajnuar se si të sillen në mënyrë etike me rastet e personave të cilët refuzojnë të përgjigjen.
- Për shkak të mungesës së sistemit të adresave, shpesh nga anketuesit është e vështirë gjetja e ndërmarrjes. Për këtë arsye, stafi i INSTAT nëpërmjet adresës së email-it ose numrit të telefonit kontakton personin përgjegjës për plotësimin e anketës dhe merr më tepër informacion mbi vendodhjen si edhe datën dhe orën e takimit.
- Prioritet i jepet bizneseve të mëdha. Kur këto ndërmarrje refuzojnë të përgjigjen për intervistuesit, një kërkesë zyrtare i drejtohet presidentit të ndërmarrjes, e cila është e nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm i INSTAT;
- Kërkesa zyrtare i dërgohet edhe për ndërmarrje të tjera që pranojnë të përgjigjen vetëm nëse ju kërkohet zyrtarisht informacioni.
- Ndërmarrjet janë të ftuar të kontaktojnë zyrat qendrore të Institutit të Statistikave në rast të pyetjeve dhe gjithmonë një staf i kualifikuar është në dispozicion për t'iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga ndërmarrjet.
- Ndërmarrjeve më të mëdha ju dërgohen çdo vit botime të INSTAT-it.

#### 13.2. Gabim i kampionimit

Treguesit e gabimeve të kampionimit janë llogaritur për indikatorët kryesorë: shitjet neto, të punësuar dhe numër ndërmarrjesh gjithsej në nivel seksioni dhe total vendi. Të gjitha vlerat e treguesve përgjithësohen për të përfaqësuar gjithë popullatën në studim.

#### 13.3. Gabim jo i kampionimit

Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën, apo kur është e pa mundur për të gjetur informacion nga burime të tjera administrative rreth ndërmarrjes.

**Shkalla e mospërgjigjes në nivel rekordi** për NVM 2022 është 15.6 %.

Mbi-mbulimi ndodh kur ndërmarrja e zgjedhur është në një aktivitet të caktuar objekt i anketimit dhe gjatë procesit të intervistimit ajo nuk është më objekt i anketimit.

**Shkalla e mbi-mbulimit** për NVM 2022 është 2.5%.

## 14. Afatet kohore dhe përpikmëria

### 14.1. Afatet kohore

Rezultatet e “Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme” janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT rreth 438 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 438 ditë). Periudha referuese e rezultateve të NVE 2022 është 31 Dhjetor 2022.

|                    |            |
|--------------------|------------|
| Periudha referuese | 12/31/2022 |
| Data e publikimit  | 3/13/2024  |
| Afatet kohore      | 438        |

### 14.2. Përpikmëria

Të dhënat e “Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme”, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i NVM 2022 ka qenë i përpiktë në kohë në 100 %.

|                    |            |
|--------------------|------------|
| Periudha referuese | 12/31/2022 |
| Data e shpallur    | 3/13/2024  |
| Data e publikimit  | 3/13/2024  |
| Vonesa në kohë     | 0          |

## 15. Koherenca dhe Krahasueshmëria

### 15.1. Krahasueshmëria gjeografike

INSTAT përdor aspektet metodologjike të cilat janë të bazuara në konceptet, përkufizimet dhe udhëzimet e Rregullores Nr 295/2008 të BE-së në lidhje me statistikat e ASN, kështu të dhënat e Shqipërisë mund të jenë të krahasueshme me vendet e BE apo vendet candidate.

Në lidhje me periudhën referuese, Shqipëria përdor vitin kalendarik, që korrespondon me vitin fiskal.

Popullsia përbëhet nga të gjitha ndërmarrjet që, sipas regjistrit statistikor të ndërmarrjeve, ishin aktive në Dhjetor të vitit referues.

Klasifikimi i ndërmarrjeve bëhet në bazë të Klasifikimit të Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 sipas Rregullores (KE) Nr 1893/2006 për "Zbatimin e NVE Rev. 2 në Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve".

Deri më tani njësit statistikore në ASN ka qenë ndërmarrja, pasi ajo përkon me njësinë ligjore në Shqipëri.

|   |  |
|---|--|
| <p>15.2. Krahasueshmëria kohore</p>             | <p>Për shkak të zbatimit të NVE Rev.2, të dhënat SBS kanë një ndërprerje të serive kohore. Statistikat e ASN-së janë dhënë çdo vit dhe janë të krahasueshme nga viti 1998 deri në 2013. Seria kohore ekziston që nga viti 1998 (si vit reference), por të dhënat nga viti 2002 e në vazhdim janë më të besueshme.</p> <p>Bazuar në NVE Rev 1.1 klasifikimi i të dhënave ASN janë të krahasueshme ndër vite nga 2002 deri në 2012, duke mundësuar një krahasueshmëri në seri kohore prej 11 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=11).</p> <p>Në NVE Rev.2 të dhënat e ASN janë siguruar nga viti 2010 e në vazhdim, duke mundësuar një krahasueshmëri në seri kohore prej 13 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=13).</p> <p>Duke filluar nga viti 2010 janë shtuar dy aktivitete të reja (arsimi dhe shëndetësia private) dhe përjashtohet peshkimi. Për aktivitete të tjera, të dhënat Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve janë të krahasueshme në vite.</p> |
| <p>15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave</p> | <p>Të dhënat e publikuara në Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve mund të gjenden në këto fusha të ndërlidhura: statistikave afatshkurtra, statistikave të tregut të punës dhe Anketa e Forcave të Punës (AFP). Pavarësisht ngjashmërisë të treguesve të prodhuar nga këto fusha, duhet theksuar se dallime metodologjike ekzistojnë mes të dhënave të ASN-së dhe të dhënave nga statistikave të tregut të punës, Anketës së Forcave të Punës dhe statistikave afatshkurtra. Për shembull, statistikave të punësimit me të dhënat e ASN-së ndryshojnë sepse në AFP janë pyetur persona në qoftë se ata kanë qenë të zënë në punë për vitin referues ndërsa në ASN pyetet ndërmarrja për numrin e personave të punësuar. Treguesi i shitjeve neto krahasohet me shitjet neto në Statistikat Afatshkurtra vetëm për të parë ecurinë e treguesit, sepse fusha e mbulimit për këto vrojttime ndryshon.</p>                                  |
| <p>15.4. Koherenca e brendshme</p>              | <p>Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre.</p>   |
| <p><b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b></p>          | <p>Personat që punojnë për NVM janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Staf i përgjithshëm në Zyrat Qendrore: 3 punonjës.</li> </ul>  |
| <p><b>17. Rishikimi i të dhënave</b></p>        |  |
| <p>17.1. Politika e rishikimit</p>              | <p>Politikat e rishikimit të ASN-së (NVM) bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e Revizionimit Statistikor;</a></li> <li>• <a href="#">Politika e Trajtimit të Gabimeve.</a></li> </ul> <p>Të dhënat paraprake deri në publikimin e rezultateve përfundimtare janë në proces rishikimi. Rishikimi nënkupton plotësimin e vazhdueshëm të të dhënave. Saktësia e të dhënave të publikuara mund të rritet si pasojë e ndryshimeve që mundësohen nga sigurimi i të dhënave të reja më të plota dhe më cilësore, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e rezultateve paraprake, të publikuara sipas</p>   |

|  |   |
|--|---|
|  | afateve të parapërcaktuara në kalendarin e publikimeve.   |
| 17.2. Praktika e rishikimit                    | <p>Të dhënat e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme rishikohen në rastet kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatohet një klasifikim i ri aktivitetesh;</li> <li>• Ka ndryshime metodologjike;</li> <li>• Rishikohen peshat (burime të reja dhe/ose burimeve të përmirësuara, korrigjime të gabimeve).</li> </ul> <p>ASN përpiqet të ndjek udhëzimet standarde dhe parime në rishikimet e bëra në bashkëpunim me asistencën teknike të marrë nga eksperiencat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian. Të gjitha rishikimet janë bërë transparente për përdoruesit dhe janë pjesë e çdo botimi.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme” për vitin 2022, subjekt i këtij raporti.</p>   |
| <b>18. Përpunimi statistikor</b>               |   |
| 18.1. Burimi i të dhënave                      | <p>Si burim i vetëm i mbledhjes së të dhënave është vrojtimi. Si bazë e zgjedhjes shërben regjistri i përditësuar i ndërmarrjeve, të cilat ishin aktive në Dhjetor të vitit të referencës. Nga ky regjistër përjashtohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njësia lokale;</li> <li>• Ndërmarrjet me veprimtari jashtë fushë së mbulimit të ASN;</li> <li>• Ndërmarrjet shtetërore në Arsim (NVE Rev. 2 85) dhe Shëndetësi (NVE Rev. 2 86, 87, 88).</li> </ul> <p>Në këtë mënyrë krijohet Frame i ASN-së i cili në total ka 118.741 ndërmarrje nga të cilat u përzgjedh kampioni me madhësi prej 18.242 ndërmarrje, nga të cilat 18.072 ndërmarrje janë “Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme”.</p> <p>Metoda e përzgjedhjes së përdorur është “Stratified Systematic Random Sampling (SRS)”. Shtresëzimi bazohet kryesisht në NVE Rev.2, dy shifror dhe madhësia e ndërmarrjeve (numri i të punësuarve). Klasifikimi i ndërmarrjeve sipas aktivitetit bëhet sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike, NVE Rev.2. Klasifikimi i ndërmarrjeve sipas madhësisë bëhet sipas numrit të të punësuarve (të matur si të punësuar me orar të plotë).</p> <p>Për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë kampion me zgjedhje për anketim. Ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht. Metoda e përdorur për shpërndarjen e kampionit nëpër shtresa (strata) është metoda e “Neyman Allocation”, në domeinet e publikimit.</p> |
| 18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave | Të dhënat e “Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme” grumbullohen në baza vjetore nga ASN.  |
| 18.3. Grumbullimi i të dhënave                 | Të dhënat e ASN mblidhen me intervistim ballë për ballë me pyetësorë letër. Programet dhe procedurat e nevojshme për hedhjen manuale të të dhënave përgatiten para se të fillojë mbledhja e të dhënave. Paraprakisht procedurat dhe programet e nevojshëm janë testuar dhe janë bërë korrigjimet eventuale. Të gjitha të dhënat janë të integruara në një bazë të dhënash të vetme, pasi është kryer hedhja dhe kontrolli i të dhënave. Vrojtimi i ASN-së ka katër pyetësorë  |

|                                |   |
|--------------------------------|---|
|                                | <p>për katër aktivitetet kryesore (të industrisë, ndërtimit, tregtisë dhe shërbimeve). Para kryerjes së anketës përdoruesit kryesorë pyeten mbi nevojat që ata kanë për shtim të pyetjeve në pyetësor. Bazuar në rezultatet e këtyre nevojave bëhet dhe dizenjimi final i pyetësorit i cili nuk ka ndryshime të mëdha në vite.</p> <p>Faza e rëndësishme në përgatitjen për grumbullimin e të dhënave është përgatitja e të gjitha materialeve të nevojshme dhe e programeve të hedhjes dhe të përpunimit të të dhënave. Duhet që të jenë përcaktuar ndërmarrjet që do intervistohen, numri i nevojshëm i anketuesve dhe duhet të jetë bërë përzgjedhja e tyre. Gjatë trajnimit të organizuar për anketuesit se si të kryejnë vrojtimin ata gjithashtu pajisen me materiale të nevojshme si udhëzuesi i pyetësorit, detyrat e anketuesit, lista e aktiviteteve ekonomik, lista e produkteve, letër njoftimit për ndërmarrjet etj. Në procesin e mbledhjes së të dhënave janë të regjistruar çdo gjë e raportuar nga ndërmarrjet. Në rast të paqartësive, ndërmarrja ri-kontaktohet. Në rast të mospërgjigjes, ndërmarrjes i dërgohet një shkresë zyrtare e nënshkruar nga titullari i institucionit. Anketuesit i kërkohet të sillen në mënyrë etike në rastet e refuzimeve nga ndërmarrjet.</p>  |
| 18.4. Vlefshmëria e të dhënave | <p>Sa i përket vlefshmërisë së të dhënave, procedurat e redaktimit të të dhënave në përgjithësi i referohen redaktimit në nivel mikro ose ndryshe në nivel ndërmarrje.</p> <p><b>1. Kontrolli fizik i pyetësorit.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli i pyetësorëve të mbledhur, kontrole të tërësisë së plotësisë, saktësisë së vlerave dhe kontrollit logjik i pyetësorit. Stafi kontrollues ka një program specifik për të kryer kontrollin matematikore të pyetësorit. Numri i pyetësorëve të mbledhur duhet të jetë i barabartë me numrin e pyetësorëve të shpërndarë në qarqe;</li> <li>• Kontrole individuale janë bërë për rastet e refuzimit dhe pa kontakte;</li> <li>• Ndërmarrjet e përgjigjura kontrollohen për koherencën e të dhënave midis sesioneve të ndryshme të pyetësorit;</li> <li>• Kontrolli i indikatorit të ndërmarrjes dhe aktivitetit ekonomik dhe kodimi i tyre.</li> </ul> <p><b>2. Kontrolli i informacionit të vrojtimit me burimet administrative.</b></p> <p><b>3. Peshë e përshtatshme rillogaritjet për çdo njësi që ka raportuar të dhënat e saj.</b></p> <p>Kjo peshë është rillogaritur për arsye të ndryshme: probabilitet i pabarabartë i përzgjedhjes, jo-përgjigje, rregullimit të vlerave të popullsisë, vlerësimi i modelit etj. Trajtimi i outlier-ave merret parasysh në procedurat e përgjithësimi të rezultateve.</p> |
| 18.5. Përpilimi i të dhënave   | <p>Për përpilimin e rezultateve kemi tre procedura bazë:</p> <p><b>1. Analiza e cilësisë së të dhënave</b></p> <p>Për të analizuar cilësinë e të dhënave janë aplikuar disa rregulla:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli matematik i anketës - Kontrolli logjik i të dhënave të anketës;</li> <li>• Krahasimi i të dhënave në seri kohore -Krahasimi i të dhënave me skedarë të tjerë që disponon INSTAT;</li> <li>• Krahasimi i të dhënave me skedarin e bilanceve;</li> <li>• Përcaktimi i kufizimeve për disa raporte, si psh: paga mesatare për të</li> </ul>   |

|                    |  |
|--------------------|--|
|                    | <p>punësuar, marzhet ndaj shitjes neto, etj;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e shmangieve të mëdha nga mesatarja.</li> </ul> <p><b>2. Trajtimi i mos-përgjigjeve.</b><br/>Konsiderohen si mos-përgjigje të gjitha rastet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pa kontakt;</li> <li>• Refuzim i plotë;</li> <li>• Refuzime të pjesshme, (për tabela apo tregues të veçantë).</li> </ul> <p>A. Për trajtimin e mos-përgjigjeve të pjesshme u përdorën disa metoda të drejtpërdrejta ose kombinimi i tyre si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Studimi i serisë kohore të ndërmarrjes dhe degës;</li> <li>• Të dhënat nga skedari i bilanceve;</li> <li>• Skedarët e tjerë që disponohen në INSTAT;</li> <li>• Analizohen dhe përdoren të dhënat mesatare të degës ku bën pjesë ndërmarrja;</li> <li>• Përdoren të dhënat e ndërmarrjeve që kanë kushte të ngjashme;</li> <li>• Përdoret metoda e strukturës mesatare sidomos për shpenzimet.</li> </ul> <p><b>3. Procedura e ri-peshimit.</b><br/>Për pjesën e pa trajtuar përdoret metoda e ri-peshimit.<br/>Programet në SAS Software, Macro Clan përdoren për ripeshim dhe për vlerësimin e të dhënave. Vlerësimi bëhet sipas metodës tradicionale të Horvitz-Thompson (i njohur edhe si vlerësuesi <math>\pi</math>), i cili aplikohet që nga faza e dizenjmit të SRS.</p> |
| 18.6. Rregullimi   | Nuk aplikohet. Asnjë përshtatje sezonale nuk i bëhet të dhënave të grumbulluara nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve.   |
| <b>19. Komentë</b> |  |
| <b>Aneks</b>       |  |
|                    |  |